Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 536/13
Datë 24.05.2013

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 mbi Kualifikimet Kombëtare të datës 7 nëntor 2008 dhe Udhëzimit Administrativ nr. 1/2011- Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me nenet 4,7,10 dhe 16, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve me datë 24.05.2013 nxjerr këtë:

VENDIM

1. Për akreditimin e New Age School, Prishtinë, me dy degë, për periudhën: 24.05.2013 - 24-05.2016 për të ofruar kurse të gjuhës angleze:

1.1. Akreditimi i institucioni/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim:

Kushtet:

- Të ofrojë dëshmi rreth politikave për zhvillim të stafit bazuar në Udhëzimet e AKK-së, dhe sistemeve efektive për zbatim të atyre politikave.

- Të sigurohet mbajtja e të dhënave për të dëshmuar se informatat kthyese të studentëve dhe kuadrit analizohen, dhe se merren veprime në bazë të atyre informatave kthyese.

- Të krijojë politika dhe procedura aty ku mungojnë momentalisht (p.sh. vlerësimi i nxënësve me nevoja të veçanta dhe transferi i kredive).

1.2. Afati i plotësimit i të gjitha kushteve është deri me 30.08.2013.

2. Arsyetim

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit, me datë: 24.05.2013, Këshilli Drejtues i AKK-së merr këtë vendim bazuar në rekomandimet të dala nga Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Akreditimin e Institucionit i cili ofron dhe/ose vlerëson dhe lëshon kualifikime të aprovuara dhe këto rekomandime janë të mbështetura në fakte dhe dokumente si në vijim:

-Aplikacioni për Akreditim si Institucionit Ofrues dhe/ose Vlerësues dhe Lëshues të Kualifikimit;
-Raporti i Vetë-vlerësimit;
-Vizita në institucionin/ofruesin aplikues, dhe
- Dokumente tjera shtesë.

2.1. Pala e pakënaqur me vendimin, ka drejtë ankese në organet e shkallës së dytë. Ankesa bëhet përmes organit të shkallës së parë.
2.2. Kushtet e parashtruara për aprovim dhe akreditim duhet të përmbushen në afatin e caktuar nga AKK, në rastin kur institucioni/ofruesi nuk i përmbushë këto kritere, AKK ka të drejtë tërheqjen e aprovimin dhe akreditimit.

3. Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit të tij.

4. Vendimi u dërgohet:

- "New Age School", Prishtinë;
- AKK-së.

Kryetari i KD së AKK-së
Ragip Gjoshi